

URDHËR
Nr. 189, datë 13.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; në nenin 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; në nenin 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; në nenin 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 79, datë 10.9.2024, të Mbledhjes së Gjyqtarëve,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për procedurat e prokurimit publik, znj. Manjola Kelolli, deri në emërimin e sekretarit të përgjithshëm.
2. Shfuqizimin e urdhrit të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 116, datë 8.7.2024, “Për delegim kompetencash”.
3. Ngarkohet znj. Manjola Kelolli me zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo